

Ringjallja

Lexo tek Alma 40:2–5, 23–24 për të parë atë që Alma i dha mësim Koriantonit. Më pas përdori burimet vijuese për të të ndihmuar ta përgatitësh më tej atë që do të japësh mësim.

Alma 11:42–45

Udhëzuesi për Shkrimet e Shenjta, “Ringjallje”, scriptures.ChurchofJesusChrist.org

Presidenti Dallin H. Oaks, i Presidencës së Parë, dha mësim:



“Ne kremtojmë realitetin e Ringjalljes në këtë periudhë Pashke. Kjo na jep perspektivën dhe forcën për t’i duruar sfidat e vdekshmërisë, me të cilat përballen secili prej nesh dhe njerëzit që i duam, gjëra të tilla si mangësitë fizike, mendore ose emocionale që i marrim në lindje ose që i përjetojmë gjatë jetës sonë në vdekshmëri. Për shkak të Ringjalljes, ne e dimë se këto mangësi të vdekshmërisë janë vetëm të përkohshme!” (Dallin H. Oaks, “Plani i Madh”, *Liahona*, maj 2020, f. 94–95)

Përgatit se si do t’i shpjegoje përgjigjet për pyetjet vijuese:

- Çfarë është ringjallja? Kush do të ringjallet?
- Sipas vargjeve tek Alma 40:2–3, çfarë e bën Ringjalljen të mundur?
- Si mund të na bekojë njohuria jonë për Ringjalljen gjatë jetës sonë në vdekshmëri?

Kur jep mësim, sigurohu që ta bësh të qartë se për shkak se Jezu Krishti u ringjall, të gjithë ne gjithashtu do të ringjallemi. Jep një arsye përse je mirënjohës për premtimin e ringjalljes.